



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/63

Datë: 29.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafit 2.4 të nenit 2 të ligjit nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, paragrafit 2.3 të nenit 2. të Ligjit nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohet Platforma Vjetore e Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Platformën nga pika 1. e këtij vendimi t'ia dërgoj për informim Komisionit për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës në Kuvendin e Kosovës, dhe Drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, për veprim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/63

Datë: 29.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, mori:


**V E N D I M**

**Për miratimin e nismës për Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë**

1. Miratohet Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë (tutje "RSSS") me qëllim që të:
  - 1.1. Të definohen Objektivat Strategjike të Kosovës dhe politikat e Sigurisë dhe mbrojtjes të Republikës së Kosovës;
  - 1.2. Të definohet në mënyrë adekuate Ambienti Strategjik i Sigurisë, Rreziqet dhe Kërcënimet e mundshme të sigurisë;
  - 1.3. Të bëhet analiza e plotë e kapaciteteve aktuale të institucioneve vendore të sigurisë;
  - 1.4. Të përcaktohen kapacitetet që i'u nevojiten institucioneve vendore të sigurisë në të ardhmen;
  - 1.5. Të bëhen rekomandime për ngritjen e kapaciteteve të nevojshme / të atyre që mungojnë, dhe për shpërbërjen e atyre që nuk janë të nevojshme;
  - 1.6. Të nxirret një Strategji e re e Sigurisë Kombëtare të Kosovës;
  - 1.7. Të ndryshohet i tërë kuadri ligjor, në bazë të rekomandimeve të RSSS-së;
  - 1.8. Të ndërtohen institucionet e sigurisë bazuar në rekomandimet e RSSS-së dhe në bazë të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë;
2. Procesi të filloj jo me vonë se në mars të vitit 2012 dhe të përfundoj jo më vonë se në qershor të vitit 2013, siç edhe është paraparë me planin e Ahtisaarit.
3. Ky proces do të udhëhiqet nga Komiteti Drejtues, i përbërë nga përfaqësuesit e këtyre institucioneve:

- 3.1. Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë, Kryesues;
  - 3.2. Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, anëtar;
  - 3.3. Ministri i Punëve të Brendshme, anëtar;
  - 3.4. Ministri i Punëve të Jashtme, anëtar;
  - 3.5. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
  - 3.6. Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtar;
  - 3.7. Ministri i Infrastrukturës, anëtar;
  - 3.8. Ministri i Financave, anëtar;
  - 3.9. Ministri i Shëndetësisë, anëtar;
  - 3.10. Drejtori i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, anëtar;
  - 3.11. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës, anëtar;
  - 3.12. Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, anëtar;
  - 3.13. Komandanti i FSK-së, anëtar;
  - 3.14. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, anëtar;
  - 3.15. Drejtori i Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave, anëtar.
4. Për Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë, Qeveria e Republikës së Kosovës fton të delegoj nga një anëtar në Komitetin Drejtues edhe:
- 4.1. Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës
  - 4.2. ICO-në
  - 4.3. Kuvendin e Republikës së Kosovës.
  - 4.4. Shoqërinë Civile
5. Emrat e të deleguarve nga pika 4. e këtij propozim-vendimi të dorëzohet në Sekretariatit e RSSS-së deri me 12.03.2012.
6. Detyrat e Komitetit Drejtues janë:
- 6.1. Të drejtoj rrjedhën e procesit,
  - 6.2. Të përcaktoj strukturën e procesit duke krijuar grupe dhe nëngrupe të veçanta pune nga secila ministri / institucion sipas nevojë,
  - 6.3. Të bëj angazhimin e një institucioni ndërkombëtar të hulumtimit, i cili do të jetë pjesë e Sekretariatit, dhe i cili do të mbështes tërë procesin,
  - 6.4. Të krijoj një mjet unik për vlerësimin e ecurisë së programit/procesit,
  - 6.5. Të prezantoj Këshillit të Sigurisë së Kosovës konkluzionet dhe rekomandimet e RSSS-së,
  - 6.6. Të angazhoj ndonjë institut apo organizatë vendore apo ndërkombëtare për ndonjë çështje të caktuar nëse e shohin të nevojshme.
7. Sekretariati i këtij procesi do të jetë Sekretariati i Këshillit të Sigurisë të Republikës së Kosovës, Detyrat e Sekretariatit do të jenë:
- 7.1. Të menaxhoj/koordinoj/mbështetjen me logjistikë organizimin e duhur dhe në kohë të të gjitha ngjarjeve që do të zhvillohen gjatë tërë procesit të RSSS-së,
  - 7.2. Të menaxhoj afatet kohore të procesit dhe afatet e fundit për të gjitha takimet dhe dorëzimet e materialeve ,
  - 7.3. Të jetë lidhja përgjegjëse në mes të Komitetit Drejtues, Institutit Ndërkombëtar të Hulumtimit dhe Grupeve Punuese Ministrore,

- 7.4. T'i mbledhë procesverbalet nga secili grup punues, t'i përmbledhë rezultatet dhe t'ua shpërndajë ato të gjitha ministrive /institucioneve të përfshira, si dhe t'i raportoj Komitetit Drejtues,
- 7.5. Të krijohet një Rrjet të Brendshëm të Komunikimit me Nivel të Lartë Sigurie për RSSS-në, në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike,
8. Të gjitha ministritë relevante janë të obliguara që të bashkëpunojnë dhe do të koordinohen me Komitetin Drejtues në zbatim të procesit të RSSS-së, si dhe t'i caktojë ekspertët e duhur në bazë të përvojës dhe njohurive, për të punuar në grupet dhe nëngrupet punuese të procesit.
9. Sekretariati i RSSS-së në bashkëpunim me Institutin Ndërkombëtar të Hulumtimit është i obliguar të organizoj paraprakisht një trajnim për RSSS, për të gjithë individët e përfshirë në këtë proces.
10. Qeveria do të ndajë një fond të veçantë për përkrahjen e këtij procesi, varësisht nga kërkesat e Komitetit Drejtues
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/63

Datë: 29.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, si dhe duke marrë parasysh Vizionin e Zhvillimit Ekonomik 2011-2014, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M**

**Për themelimin e Komisionit Qeveritar për Rishikimin e akteve nënligjore të miratuara nga Qeveria dhe ministrinë**

1. Komisioni përbëhet nga këta përfaqësues:

1.1. Besim M. Kajtazi-ZL/ZKM	Kryesues
1.2. Eset Rama-SKQ/ZKM	Zëvendës kryesues
1.3. Ruzhdi Halili-ZPS/ZKM	anëtar
1.4. Arben Çitaku MMPH	anëtar
1.5. Besnik Osmani-MAPL	anëtar
1.6. Agim Krasniqi-MF	anëtar
1.7. Irfan Lipovica-MTI	anëtar

2. Në cilësinë e ekspertëve dhe vëzhguesve ftohen:

- 2.1. Përfaqësues nga Kabineti i Kryeministrit;
- 2.2. Përfaqësues nga Kabineti i Zëvendëskryeminstres Mimoza Kusari-Lila;
- 2.3. Ardian Kryeziu- zv. Drejtor USAID/Programi për përmirësimin e mjedisit afarist në Kosovë (*USAID/Business Enabling Environment Program in Kosovo*);
- 2.4. Brian Kemple, Udhëheqës i Komponentës për Përmirësimin e Legjislacionit, nga USAID/Programi për përmirësimin e mjedisit afarist në Kosovë (*USAID/Business Enabling Environment Program in Kosovo*);
- 2.5. Shpresa Kastrati, Përfaqësuese e IFC/ Banka Botërore;
- 2.6. Blerta Qerimi BETA/Banka Botërore;

3. Duke u bazuar në Regjistrin e akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga Qeveria dhe ministrat (Regjistri i miratuar me Vendim të Qeverisë nr. 08/35 të datës 01.09.2011, dhe i përditësuar nga Zyra Ligjore - ZKM sipas pikës 5 të këtij Vendimi), të gjitha ministratë obligohen të bëjnë një rishikim të çdo akti nënligjor si dhe të përpilojnë një listë të akteve nënligjore të cilat dëshirojnë t'i mbajnë (bazën ligjore dhe arsyen dhe për një gjë të tillë) si dhe të tregojnë për ato që duhet të shfuqizohen, ndryshohen apo plotësohen.
4. Rishikimi i akteve nënligjore sipas pikës tre (3) të këtij Vendimi do të bëhet duke aplikuar Udhëzimet për rishikimin e akteve nënligjore të bashkangjitura këtij Vendimi dhe propozimi me listën përkatëse, dhe së bashku me informacionet tjera relevante i dërgohen Komisionit.
5. Komisioni shqyrton propozimin e ministrive dhe sipas nevojës takohet me ministratë për të diskutuar propozimet e ministrive. Komisioni bën rekomandimet e veta përfundimtare, për secilin akt, se a duhet të ruhet ashtu siç është, të shfuqizohet, apo të korrigjohet.
6. Secila ministri bën korrigjimet siç i rekomandohet nga Komisioni, aktet nënligjore të përcaktuara nga Komisioni duhet të korrigjohen dhe të korrigjuara i dorëzohen Komisionit për miratim.
7. Komisioni korrigjon, sipas rastit, aktet nënligjore që do të mbesin në fuqi, në përgjigje të komenteve të pranuar nga publiku.
8. Komisioni në afat prej gjashtë muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, paraqet për miratim në Qeveri regjistrin e akteve nënligjore që do të mbesin në fuqi dhe që parasheh se çdo akt nënligjor që nuk është në listën përfundimtare konsiderohet i shfuqizuar. Ky regjistër do të publikohet edhe në Gazetën Zyrtare.
9. Aktet nënligjore në listën finale që kanë të bëjnë me masat për sistemin e licencave, lejeve ose inspektimet shënjojnë për shqyrtim të mëtejshëm në të ardhmen në lidhje me reformat në sistemin lejuar dhe në inspektime.
10. Zyra Ligjore - Zyra e Kryeministrit publikon aktet nënligjore që do të mbesin në fuqi, përfshirë ato që janë korrigjuar.
11. Sipas nevojave të punës dhe për realizimin e obligimeve të parapara me këtë Vendim Komisioni mund të krijojë Trupa punese me përfaqësues të të gjitha institucioneve qeveritare të cilët do të punojnë sipas kërkesave të Komisionit.
12. Zyra Ligjore-ZKM në bashkëpunim me Sekretariatit Koordinues të Qeverisë bëjnë rishikimin e Vendimeve të Qeverisë, duke aplikuar Udhëzimet për rishikimin e akteve nënligjore të bashkangjitura këtij Vendimi dhe i japin të gjeturat lidhur me secilin akt nënligjor Komisionit së bashku me informacionet tjera relevante. Pas miratimit nga Komisioni Regjistri i Vendimeve në fuqi i paraqitet për miratim Qeverisë.

13. Obligohen të gjitha ministrinë të kryejnë përgjegjësitë e përcaktuara me këtë Vendim, të bashkëpunojnë me Komisionin dhe t'u përgjigjen kërkesave të Komisionit.
14. Për mbarëvajtjen dhe realizimin e përgjegjësiave të përcaktuara në këtë Vendim, në ministri përgjegjës janë sekretarët e përgjithshëm të ministrive.
15. Në afat prej një muaji pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ministrinë kryejnë obligimet e tyre të përcaktuara në pikën tre të këtij Vendimi.
16. Në afat prej gjashtë muajsh Komisioni obligohet të paraqesë për miratim Regjistrin e akteve nënligjore në fuqi që përfshijnë aktet nënligjore të miratuara nga Qeveria dhe aktet nënligjore të miratuara nga ministrat.
17. Në afat prej tre muajsh Komisioni paraqet për miratim në Qeveri Regjistrin e Vendimeve në fuqi të miratuara nga Qeveria.
18. Zyra Ligjore harton raporte në baza mujore për Kryeministrin lidhur me realizimin dhe ngecjet eventuale për punën e këtij Komisioni.
19. Zyra Ligjore ofron gjithë ndihmën e nevojshme për punën e Komisionit që ky proces të shkojë sipas ecurisë së paraparë.
20. Udhëzimet për rishikimin e akteve nënligjore të miratuara nga Qeveria dhe ministrinë, janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
21. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/63

Datë: 29.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohet Koncept-dokumenti për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-36 për Duhanin.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/63

Datë: 29.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohet Koncept-dokumenti për hartimin e Projektligjit për Transplantimin e Organeve dhe Projektligjit për Transplantimin e Qelizave dhe Indeve.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/63

Datë: 29.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 85,555.00 euro për Ministrinë e Punëve të Jashtme, për Atasheun Ushtarak në misionin diplomatik të Republikës së Kosovës në Uashington DC të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, programi Shpenzimet e paparashikuara, me kod 232-13, kategoria ekonomike Rezervat dhe transferohen në programin me kod 216-143-Ambasadat, si vijon:
  - 2.1. 26,100.00, euro në kategorinë ekonomike - paga dhe mëditje;
  - 2.2. 6,000.00 euro, në kategorinë ekonomike - shpenzime komunale, dhe
  - 2.3. 53,455.00 euro, në kategorinë ekonomike - mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/63


Datë: 29.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M - P R E L I M I N A R**

1. Miratohet shpronësimi, për interes publik i shtëpisë të pronarit të pronës së paluajtshme ngastra kadastrale nr.600/6 Zona Kadastrale Polac, Komuna Skenderaj e cila preket nga ndërtimi i rrugës regjionale Polac-Vushtrri në Komunën e Skenderajt sipas tabelës të bashkangjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Kuvendi Komunal, Skenderaj në territorin e të cilit gjendet ngastrat kadastrale.
3. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Skenderaj, brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, të njoftojë pronarin, shtëpia e të cilit do të shpronësohet dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.
4. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues, dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.

5. Vendimi hyn në fuqi me datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.

  
Hashim THAÇI

\_\_\_\_\_  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/63

Datë: 29.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 1,000,000.00 (një milion) euro për përkrahjen e zhvillimit të projekteve kapitale në komunat si në vijim:
  - 1.1. Komunës së Shtërpcës, 400,000.00 (katërqind mijë) euro;
  - 1.2. Komunës së Graçanicës, 200,000.00 (dyqind mijë) euro dhe
  - 1.3. Komunës së Drenasit, 400,000.00 (katërqind mijë) euro.
2. Mjete nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezerva e Qeverisë, programi "Shpenzimet e paparashikuara", kategoria ekonomike Shpenzimet kapitale dhe transferohen në komunat, e cekura në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe komunat e cekura në pikën 1. për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/63

Datë: 29.02.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohet në parim Draft Protokolli Teknik për zbatimin e konkluzioneve të pajtuara për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (M.I.K) nga Dialogu i datës 2 dhjetor 2011 (23 shkurt 2012) (*Technical Protocol for Implementation of IBM Agreed Conclusions of the Dialogue of 2 December 2011 (23 February 2012)*).
2. Autorizohet Ministri i Punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi për nënshkrimin dhe Këmbimin e Notave ndërmjet Qeverisë së Republikës Kosovës me autoritetin kompetent të BE-së.
3. Pas shkëmbimit të notave ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës me autoritetin kompetent të BE-së, Protokolli Teknik për zbatimin e konkluzioneve të pajtuara për M.I.K nga Dialogu i 2 dhjetorit 2011, hyn në fuqi pas ratifikimit nga Presidenti, të cilat dërgohen nga Ministri i Punëve të Jashtme në pajtim me nenin 10 (paragrafi 4 dhe paragrafi 8).
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë